

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

PA-II-KZ-5/2014


01 tetor 2014

Në Emër të Popullit

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, me kolegjin e përbërë nga Gjyqtarja e Gjykatës Supreme, Nesrin Lushta, Kryetare e kolegjit, Gjyqtarja e EULEX-it, Esma Erterzi, Gjyqtare raportuese, Gjyqtari i EULEX-it, Willem Brouwer, anëtar i kolegjit, me pjesëmarrjen e këshilltarit ligjor të EULEX-it, Adnan Isufit, duke vepruar si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të pandehurve:

Jovica Dejanoviç, emri i babait, [REDAKTUAR] emri i nënës, [REDAKTUAR] - [REDAKTUAR] i lindur më 11 shtator 1954, në Gllatovinë, Komuna e Vushtrrisë, banor i lagjes Prilluzhije, Komuna e Vushtrrisë, Mitrovicë, zyrtar i policisë, i diplomuar në shkollën teknike, nuk ka të dhëna penale, i akuzuar të ketë kryer veprat e pretenduara penale të **Krimeve të luftës kundër popullatës civile**, në pajtim me nenet 22 dhe 142, të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), e cila aktualisht penalizohet sipas neneve 31 dhe 153 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe të **Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve**, në pajtim me nenin 328, të Kodit të Përkohshëm Penal të Republikës së Kosovës (KPPK) e cila aktualisht është e dënueshme sipas nenit 374, të KPK-së.

Gjorgje Bojkoviç, emri i babait, [REDAKTUAR] emri i nënës, [REDAKTUAR] - [REDAKTUAR] i lindur më 13 nëntor 1940, në Babin Most, Komuna e Obiliqit, Prishtinë, banor i Babin Most, aktualisht në pension, nuk ka të dhëna penale, i akuzuar të ketë kryer veprat e pretenduara penale të **Krimeve të luftës kundër popullatës civile**, në pajtim me nenet 22 dhe 142, të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), e cila aktualisht penalizohet sipas neneve 31 dhe 153 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe të **Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve**, në pajtim me nenin 328, të Kodit të Përkohshëm Penal të Republikës së Kosovës (KPPK) e cila aktualisht është e dënueshme sipas nenit 374, të KPK-së.



Duke vepruar sipas ankesës së avokatit mbrojtës, Lubomir Pantoviç të datës 07 korrik 2014, në emër të të pandehurit Jovica Dejanoviç dhe ankesës së avokatit mbrojtës Miodrag Brklaç të datës 09 korrik 2014, në emër të të pandehurit Gjorgje Bojkoviç, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PaKr 503/13, të datës 27 maj 2014.

Duke e marrë parasysh mendimin e Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës të datës 23 korrik 2014,

pas mbajtjes së seancës publike më 30 shtator 2014, me të gjitha palët të informuara dhe të ftuara me kohë (pala e dëmtuar ishte informuar në mënyrë elektronike por nuk kishte mundësi që të marr pjesë për shkak se ishte jashtë vendit), me praninë e Prokurores, Jaroslava Novotna, të të pandehurve dhe avokatëve mbrojtës Z. Pantoviç në emër të J. Dejanoviç dhe Z. Brklaç, në emër të D. Bojkoviç.

Pas mbajtjes së këshillimit më 30 shtator dhe votimit më 01 tetor 2014, sipas nenit 398 në lidhje me nenin 407 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), Gjykata Supreme e Kosovës lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Ankesa e avokatit mbrojtës Lubomir Pantoviç e datës 07 korrik 2014, e paraqitur në emër të pandehurit Jovica Dejanoviç dhe ankesa e avokatit mbrojtës Miodrag Brklaç e datës 09 korrik 2014, e paraqitur në emër të të pandehurit Gjorgje Bojkoviç kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PaKr 503/13 të datës 27 maj 2014, janë të bazuara.

Ndryshohet aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së Apelit, PaKr 503/13, i datës 27 maj 2014, lidhur me veprën penale të Krimeve të luftës mbi popullatën civile, sipas neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), e cila aktualisht penalizohet sipas neneve 31 dhe 153 të Kodit penal të Republikës së Kosovës (KPRK), ashtu që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P 13/2013 i datës 17 prill 2013 vërtetohet dhe të pandehurit Jovica Dejanoviç dhe Gjorgje Bojkoviç lirohen nga vepra penale Krime të luftës mbi popullatën civile, sipas neneve 22 dhe 142, të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ). Pjesa e mbetur e aktgjykimit të ankimuar nuk i ishte objekt i shqyrtimit.



ARSYETIM

I. Historia e procedurës

Më 12 nëntor 2012, Zyra e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzën PPS nr. 89/2012 kundër të akuzuarve Jovica Dejanoviç dhe Gjorgje Bojkoviç pranë ish Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, e cila është ndryshuar me datën 30 nëntor 2012, me aktvendimin e Gjykatës.

Prokuroria pretendon se i pandehuri Jovica Dejanoviç, në cilësinë e zyrtarit të policisë serbe ka dhunuar V. K. [REDAKTUAR] një femër civile shqiptare nga Kosova. Ai ishte i armatosur me pushkë, e rrëmbeu atë nga shtëpia e saj, e dërgojë viktimën në një vend të panjohur afër fshatit Babin Most, dhe e detyrojë atë duke e kërcënuar me thikë, që të ketë lloje të ndryshme të marrëdhënieve seksuale kundër vullnetit të saj, brenda veturës së tij. Më tej, Prokuroria ka akuzuar të pandehurin Jovica Dejanoviç se ka poseduar armë pa autorizim të vlefshëm, të gjetura gjatë bastisjes së vendbanimit të tij.

Prokurori gjithashtu ka argumentuar në aktakuzë se i pandehuri i dytë Gjorgje Bojkoviç, i cili kishte pasur armë me veti, e dërgojë viktimën në një shtëpi të pa kryer në fshatin Babin Most, e hodhi viktimën në dysheme dhe e detyrojë atë që të ketë marrëdhënie seksuale pa dëshirën e saj. Prokuroria gjithashtu ka akuzuar të pandehurin Gjorgje Bojkoviç për posedim të armëve pa autorizim të vlefshëm.

Më 05 shkurt 2013, Gjykata Themelore në Mitrovicë nxori vendimin mbi refuzimin e kërkesës së avokatit mbrojtës për hedhjen poshtë të aktakuzës dhe kundërshtimeve të mbrojtjes mbi pranueshmërinë e provave. Ky vendim ishte vërtetuar me anë të vendimit të Gjykatës së Apelit të datës 06 mars 2013. Shqyrtimi kryesor është mbajtur në mes të 04 dhe 15 prillit 2013.

Më 17 prill 2013, Gjykata Themelore në Mitrovicë ka shpallur Aktgjykimin.

I pandehuri Jovica Dejanoviç ishte liruar nga të gjitha veprat penale në aktakuzë.

I pandehuri, Gjorgje Bojkoviç ishte liruar nga dy akuza të Krimeve të luftës mbi popullatën civile (dhunim), të dënueshme sipas neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të



Jugosllavisë (KPRSFJ). Megjithatë, ai është shpallur fajtor për veprën penale të Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, sipas nenit 328 (aktualisht e dënueshme sipas nenit 374, të KPK-së) dhe është dënuar me 1 vit e 6 muaj burgim. Dënimi ishte pezulluar për një periudhë të verifikimit prej 2 viteve. I akuzuari Bojkoviç ishte urdhëruar që të paguajë 100 euro si pjesë e shpenzimeve dhe u lirua nga obligimi që të paguajë pjesën e mbetur të shpenzimeve.

Më 31 tetor 2013, Prokurorët e PSRK-së kanë paraqitur ankesë të përbashkët duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe të pandehurit J. Dejanoviç dhe D. Bojkoviç të dënohen për veprën penale të Krimeve të luftës kundër popullatës civile apo në mënyrë alternative çështja të kthehet për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Parashtruesit e ankesës kanë pohuar se trupi gjykues ka vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë dhe aktgjykimi i kundërshtuar është marrë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Avokati mbrojtës i të pandehurit J. Dejanoviç ka paraqitur përgjigje në ankesë të datës 15 nëntor 2013, duke propozuar refuzimin e ankesës së Prokurorit si të pabazuar dhe vërtetimin e aktgjykimit të kundërshtuar të Gjykatës Themelore në pjesën që ka të bëjë me të pandehurin J. Dejanoviç.

Avokati mbrojtës i të pandehurit D. Bojkoviç ka paraqitur përgjigje në ankesën e Prokurorëve 2013, duke propozuar refuzimin e ankesës së Prokurorit në pjesën që ka të bëjë me D. Bojkoviç si të pabazuar dhe vërtetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Në anën tjetër, mbrojtja ka parashtruar një ankesë në emër të të pandehurit, D. Bojkoviç të datës 29 tetor 2013, duke propozuar që akuzat kundër klientit të tij të refuzohen për shkak të hyrjes në fuqi të Ligjit për Amnisti. Prandaj, procedura penale kundër klientit të tij duhet të ndërpritet. Ai gjithashtu ka kërkuar që shpenzimet e procedurës penale në lidhje me D. Bojkoviç të mbulohen nga fondet publike.

Prokurori Publik i Apelit i ka propozuar Gjykatës së Apelit që ta pranojë ankesën e Prokurorit Special, të ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar siç është propozuar ose ta anulojë këtë pjesë të aktgjykimit dhe lëndën ta kthejë për rigjykim. Ai më tej ka propozuar që të refuzohet ankesa e avokatit mbrojtës të të pandehurit D. Bojkoviç, përveç në lidhje me dënimin, që duhet të anulohet bazuar në Ligjin për Amnisti. Arma e gjetur dhe karikatorit të konfiskohen.



Më 27 maj 2014, Gjykata e Apelit lëshoi aktgjykimin e saj.

Ankesat e Prokurorit Special dhe ankesa e avokatit mbrojtës Miodrag Brklaç në emër të të pandehurit, Gjorgje Bojkoviç ishin pranuar pjesërisht.


Aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës Themelore të Mitrovicës, në lëndën me numër P 13/2013, të datës 17 prill është ndryshuar duke zbatuar Ligjin për Amnisti, aktakuza është hedhë poshtë në pjesën ku i pandehuri, Gjorgje Bojkoviç ishte akuzuar për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim të nenin 328, (2) të KPK-së (tani neni 374 i KPRK-së), kurse lirimi i të dy të pandehurve nga vepra penale për Krime të luftës kundër popullatës civile sipas nenit 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), ishte anuluar dhe që të dy të pandehurit dënohen për veprën penale të Krimeve të luftës kundër civilëve sipas nenit 142 të KPRSFJ-së (tani neni 153 i KPRK).

Bazuar në dispozitat që shkojnë në dobi të të pandehurve dhe duke marr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, Gjykata e Apelit ka vendosur që i pandehuri Jovica Dejanoviç të dënohet me 12 vite burgim, ndërsa i pandehuri Gjorgje Bojkoviç me 10 vite burgim. Aktgjykimi i kundërshtuar i gjykatës së shkallës së parë ishte vërtetuar në pjesët e mbetura.

Të pandehurit, Jovica Dejanoviç dhe Gjorgje Bojkoviç janë urdhëruar që të dy të paguajnë 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro si pjesë e shpenzimeve të procedurës penale.

Më 07 korrik 2014, avokati mbrojtës Lubomir Pantoviç, në emër të të pandehurit Jovica Dejanoviç, përkatësisht më 09 korrik 2014, avokati mbrojtës Miodrag Brklaç në emër të të pandehurit Gjorgje Bojkoviç kanë paraqitur ankesat e tyre kundër aktgjykimin të Gjykatës së Apelit PaKR 503 të datës 27 maj 2014.

Më 23 korrik 2014, Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës dorëzoi mendimin e saj duke i propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës që të refuzohen ankesat e avokatëve mbrojtës si të pabazuara dhe të vërtetohet aktgjykimi i kundërshtuar.



Pas mbajtës së seancës publike më 30 shtator 2014, dhe pas këshillimit dhe votimit me datën 30 shtator dhe 01 tetor 2014, në pajtim me nenin 403, paragrafin 2, të KPP-së, Gjykata Supreme e Kosovës lëshoi aktvendimin mbi lirimin e menjëhershëm të të pandehurve nga paraburgimi.

II. Përmbajtja e ankesave

Avokati mbrojtës, Lubomir Pantoviç kundërshtoi aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës së Apelit mbi bazat e:


- Shkeljeve Esenciale të dispozitave të procedurës penale,
- Shkeljes esenciale të ligjit penal,
- Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vendimit mbi dënimin dhe shpenzimet për procedurat penale.

Z. Pantoviç pretendon në shkelje të nenit 384, paragrafit 2.1 ta KPPK-së, se arsyet mbi faktet vendimtare të dhëna në aktgjykimin e ankimuar janë tërësisht të paqarta - në lidhje me një numër pyetjesh që kanë të bëjnë me thelbin e lëndës, sikurse numri i dhunuesve, mënyra se si ajo ishte dhunuar, armët me anën e së cilave ajo ishte frikësuar, vendi ku ajo ishte dhunuar, emri në të cilin dhunuesi përgjigjej, etj. Avokati mbrojtës më tej thekson se nuk ka dëshmi të sakta se dhunimi kishte ndodhur fare, pasi që nuk ka dokumentacion mjekësor.

Ai ka parashtruar se aktgjykimi i ankimuar nuk ka thënë asnjë fjalë lidhur me kualifikimin që ka të bëjë me Konventën e Katërt të Gjenevës dhe me Protokollet e saj Shtesë, duke lënë dilema nëse Gjykata e Apelit ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë sa i përket kualifikimit ligjor të veprës penale, apo jo.

Ai gjithashtu ka argumentuar se Gjykata e Apelit iu ka referuar vetëm nenit 142, të Ligjit Penal të RSFJ-së, pa specifikuar se cili paragraf duke e ditur se neni i referuar ka tri paragrafë.

Ai ka thënë se Gjykata e Apelit nuk ka pasur rastin që të shoh apo dëgjojë madje as një dëshmitar të vetëm, e as të pandehurit, deri sa ka dënuar të pandehurit duke mos u përpjekur që të korrigjojë mangësitë, qoftë përmes kthimit të lëndës për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, apo duke hapur shqyrtimin në Gjykatën e Apelit.



Ai pretendon në shkeljen e parimit "*dubio pro reo*".

Ai kundërshton vërtetimin e fakteve nga ana e Gjykatës së Apelit. Ai ka argumentuar se kryerja e krimit në fjalë nga i pandehuri nuk është vërtetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Në këtë kuptim, ai ka thënë se viktima ka dhënë pesë deklaratata të ndryshme dhe ka dhënë deklaratën e saj në shqyrtimin kryesor përmes video lidhjes dhe se ajo nuk është e besueshme.

Ai iu ka referuar mospërputhjeve në deklaratën e saj, të dhëna në kohë të ndryshme, që kanë të bëjnë:

- Numrin e dhunuesve;
- llojet e raportit seksual;
- nëse ajo i ka thënë familjes së saj se ishte dhunuar, menjëherë pas ngjarjes së ndodhur;
- nëse ajo ka përmendur dhunimin fillimisht tek vëllezërit e saj, apo jo;
- nëse dhunuesi kishte, apo jo nofkën Pero;
- nëse dhunuesi kishte fasha në dorën e tij të djathtë, apo në dorën e majtë;
- nëse ajo kishte parë kryerësin e veprës për herë të parë më 14 prill 1999, apo një ditë më herët;
- nëse dhunuesi mbante armë automatike të drejtuar në qafën e saj, apo jo;
- nëse dhunuesi kishte kërcënuar atë me thikë gjatë dhunimit, apo jo;
- nëse ajo i kishte treguar nënës së saj se çka i kishte ndodhur pasi që ishte kthyer në shtëpinë e saj, apo ajo kurrë nuk i ka treguar asaj për dhunimin, pasi që i vinte turp;
- Nëse ajo i kishte treguar axhës së saj, M. K. se shtëpia në të cilën ajo ishte dhunuar ishte afër hotel "Amazon", apo, sikurse që axha kishte deklaruar, se shtëpia ishte 2.7 kilometra më tej në drejtim të Prishtinës, në kryqëzimin Obiliq - Podujevë, etj.

Sa i përket deklaratave të dëshmitarit, ai në veçanti ka argumentuar:



- Nëse, axha M.K. ishte në gjendje të e njoh personin i cili kishte rrëmbyer V.K. apo jo, pasi që ishte errësirë;
- nëse deklaratat e dëshmitarëve janë në kundërshtim me njëra tjetrën, apo jo;
- nëse axha M.K. ka konfirmuar se ishte muzg kur viktimja ishte rrëmbyer, ndërsa dëshmitari I.G. ka deklaruar se, edhe pse ishte errësirë, ajo ka parë zyrtarin e policisë i cili kishte flokë të shkurtër të zeza, vetulla të zeza dhe sy të zinj;
- se të gjithë dëshmitarët e prokurorisë kishin përshkruar zyrtarin e policisë si njeri të "gjatë", në mes të 27 dhe 35 vjeçar dhe dëshmitari S.K. ka përshkruar dhunuesin si një "njeri të ri me një trup atleti, deri sa i pandehuri në atë kohë ishte 45 vjeçar;
- se nëna e viktimës, në deklaratën e saj të dhënë për hetuesit e UNMIK-ut, më 31 mars 2003 ka thënë se ajo nuk mund të përshkruaj pamjen e zyrtarit të policisë dhe se albumi i fotografive të treguara asaj në të cilën ishte fotografia e Jovica Dejanoviç ajo ishte përgjigjur se nuk e njihnte askënd ndërsa më 21 maj 2012, kur albumi i fotografive i ishte treguar kësaj dëshmitare nga Policia e Kosovës, ajo menjëherë ka treguar fotografinë e Jovica Dejanoviç.
- se dëshmitari I. K ka deklaruar që zyrtari policor kishte flokët e ngritura lartë kurse gjatë procesit të identifikimit në shqyrtimin kryesor, një fotografi e Jovica Dejanoviçit është paraqitur ku ai mbante flokët poshtë ballit të tij.
- se dëshmitari, N.K. ka deklaruar se zyrtari i policisë kishte gjithashtu të ashtu quajturën "Kapelë me mburojë" në kokën e tij dhe edhe pse ishte errësirë dhe edhe pse një kapelë e tillë mbulon flokët dhe ballin e personit që e mban, ajo pagabueshëm e zgjedh Jovica Dejanoviç nga fotografia.

Avokati mbrojtës më tutje thekson se:

- Hetuesit vendor kanë shënjuar fotografinë e Jovica Dejanoviç, kështu që në shikim të parë ishte ndryshe nga fotografitë e tjera;



- Në albumin e fotografive identifikuese, të gjitha fotografitë tjera ishin të ngjitura pa metal në letër, deri sa fotografia e Jovica Dejanviç ishte ngjitur në letër me kapëse metalike, kështu që të dallohej nga të tjerat.

Avokati mbrojtës, në anën tjetër, argumenton, që edhe pse Gjykata e Apelit ka pranuar se neni 255, paragrafi 3, i KPRSFJ-së e cila përshkruan procedurën e identifikimit nuk ishte respektuar, ka pranuar rezultatet e këtij hetimi të mangët dhe problematik.

Ai ka pretenduar se gjetja e Gjykatës së Apelit se viktimë ishte rrëmbyer dhe ishte dërguar në fshatin Babin Most, jo shumë larg nga Çiçavica, vendi ku i pandehuri ka jetuar, nuk është i saktë sepse Çiçavica nuk është vend ku i pandehuri jeton por është mal ku i pandehuri kurrë nuk ka jetuar.


Avokati mbrojtës, Miodrag Brklač, në emër të të pandehurit Bojkoviç, ka kundërshtuar aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës së Apelit mbi bazat e:

- Shkeljeve Esenciale të dispozitave të procedurës penale,
- Shkeljes esenciale të kodit penal,
- Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vendimit mbi dënimin.

Ai ka argumentuar se në qoftë se Gjykata e Apelit ka pranuar tezat e PSRK-së që kanë të bëjnë me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit, do të duhej që të anulonte aktgjykimin dhe të e dërgonte lëndën për rigjykim, apo të hapte vet shqyrtimin për të nxjerrë prova të reja apo që të përsërit ato të cekurat, në pajtim me nenet 402.1.1 dhe 402.1.1 dhe nenin 392.2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Ai më tej thekson se Gjykata e Apelit ka pranuar se personat në fotografi që i janë treguar viktimës gjatë identifikimit së bashku me fotografitë e të pandehurit Bojkoviç nuk ishin mjaftueshëm të ngjashme me të pandehurin. Avokati mbrojtës vjen në përfundim se kjo mund të zvogëlojë besueshmërinë e identifikimit në një shkallë të caktuar.

Ai ka deklaruar se është qartë e dukshme se fotografia e të pandehurit tregon një njeri të vjetër deri sa të gjitha fotografitë e tjera paraqesin persona në mënyrë të konsiderueshme më të rinj se sa i pandehuri dhe janë tërësisht dalluese. Ai ka ngritur argumentin që pasi që viktimë tani më kishte



thënë se dhunuesi ishte një njeri i vjetër, është normale që dëshmitari apo viktimi të zgjedh fotografinë e një personi të vjetër. Kështu që, do të ishte e qartë se fotografia e të pandehurit Bojkoviç do të zgjidhej gjatë identifikimit pasi që vetëm një fotografi e një personi të vjetër ishte aty.

Avokati mbrojtës gjithashtu argumenton se hetuesit të cilët kanë udhëhequr hetimin, që të dy ishin shqiptarë. Ata nuk kanë mundur që të gjejnë ndonjë fotografi të të pandehurit Bojkoviç nga periudha kohore kur krimi ishte kryer dhe kur viktimi pretendohet ta ketë parë. Pra, ata kanë përfshirë në mesin e fotografive, fotografinë që ishte bërë 10 vite më vonë kur i pandehuri Bojkoviç qartë ishte më i vjetër se sa kur ishte në vitin 1999.


Viktima, kur e përshkroi këtë njeri të vjetër tek dëshmitari S.K., kurrë nuk e ka përmendur se ai çalonte por ajo ka thënë se ai ishte një njeri i vjetër plak. Ai ka thënë se kjo nuk ishte marr parasysh nga Gjykata e Apelit. Avokati mbrojtës ka thënë se i pandehuri nuk çalon, por ecja e tij është karakteristike për njeriun e moshës së tij, sikurse që është thënë nga gjykata e shkallës së parë.

Avokati mbrojtës më tej argumenton se deklaratat e viktimës të dhëna gjatë procedurës kanë mungesë të kredibilitetit dhe të besueshmërisë për shkak të mospërputhjeve:

- Në numrin e dhunuesve;
- nëse ajo i ka thënë familjes së saj se çka kishte ndodhur kur ishte kthyer në shtëpi;
- kush ishin të pranishëm në oborr kur ajo hyri në oborrin e shtëpisë së axhës së saj, pas incidentit; dhe,
- nëse personi i parë që ajo i kishte treguar se çka i kishte ndodhur asaj, ishte vëllau i saj N [REDACTED] apo jo, pasi që ai nuk e kishte konfirmuar këtë.

Avokati mbrojtës argumenton se Gjykata e Apelit nuk i kishte përmendur deklaratat e dhëna nga dëshmitarët e tjerë që ishin dëgjuar në këtë lëndë mbi pretendimet nëse Bojkoviç çalon. Ai gjithashtu kundërshton se kurrë nuk është vërtetuar se Bojkoviç e kupton dhe e flet gjuhën shqipe.

Avokati mbrojtës i argumenton si të gabueshme përfundimet e Gjykatës së Apelit në atë se i pandehuri, Bojkoviç çalon deri sa ec dhe se nofka e tij është "Copa". Ai ka pohuar se gjykata e




shkallës së parë nuk e ka përcaktuar se i pandehuri Bojkoviç çalon deri sa ec, e as nëse ndokush ndonjëherë në jetën e tij e ka quajtur të pandehurin “Copa”. Ai ka argumentuar se vetëm viktima e ka përshkruar dhunuesin e dytë në detaje si një njeri të vjetër që çalon. Ai ka thënë se viktima që nga viti 1999 gjithmonë ka përshkruar dhunuesin e dytë si një njeri të vjetër.

Në deklaratën e saj, në vitin 1999, pala e dëmtuar kurrë nuk e ka përshkruar Bojkoviç, në fakt ajo nuk e ka përmendur bashkëkryerësin e dytë deri në vitin 2010 kur ajo ka thënë se njeriu i dytë ishte në mes 60 dhe 70 vjeçar. Ai më tej ka thënë se Gjykata e Apelit ndoshta ka pasur për qëllim që të thotë se viktima ka thënë dhe ka përshkruar njeriun e dytë tek dëshmitari S.K., personi i dytë ishte “Matuf”, apo kur të përkthehet është si “njeri i vjetër”. Sido që të jetë, në atë kohë i pandehuri Bojkoviç nuk ishte njeri i vjetër e as që do mund të konsiderohej plak.

Z. Brklač argumenton se Gjykata e Apelit ka gabuar kur i është referuar “hulumtimit” të bërë nga vëllai i viktimës në vitin 2008 thjesht duke e pranuar deklaratën e tij se “dikush” nga Babin Mosti, me rastin e përmendjes së një njeriut të vjetër i cili çalon, menjëherë ka thënë Doko (i pandehuri D. Bojkoviç) gjithashtu kur ka përfunduar se i pandehuri e ka ditur saktësisht ku ta dërgonte viktimën dhe ta kryej dhunimin sepse nuk mund të jetë i rastësishëm fakti se i pandehuri tjetër dhe vëllau i tij ndërtonin dy shtëpi në atë fshat afër njëra tjetrës.

Ai më tej argumenton se dëshmia e dëshmitarit nuk është e besueshme kur ai thotë se ka pasur shenjë të dukshme të kafshimit në trupin e saj, në barkun e saj, nën gjinj të saj - jo më shumë se 20 dhe jo më pak se 4, dhe se ajo i kishte thënë atij se ishte dhunuar nga tre njerëz, të cilën ajo vetë kurrë nuk e ka thënë në ndonjërin nga deklaratat e saja.

Avokati mbrojtës ka thënë se Gjykata e Apelit ka vepruar në kundërshtim me parimin *in dubio pro reo* dhe parimi se fajësia e të pandehurit duhet që të përcaktohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm e që nuk është rasti këtu. Në këtë kontekst, avokati mbrojtës kundërshton deklaratat e dëshmitarëve sa i përket vlerës së tyre për të vërtetuar fajësinë përtej dyshimit të bazuar. Z. Brklač ka thënë se nëna e viktimës në dy deklaratat e saj nuk e ka përmendur fare që vajza e saj ishte dhunuar apo nëse e ka pyetur vajzën e saj pas ngjarjes.



Avokati mbrojtës më tej ka thënë se dëshmitarja, M.K. ka thënë se ajo kishte dëgjuar nga familja e saj se V.K. ishte dhunuar nga personat të cilët e kishin grabitur atë dhe jo nga vetë viktima por çfarë ka thënë ajo ishte se viktima ka deklaruar se ishte dhunuar. Ai gjithashtu ka diskutuar se dëshmitari I.G. ka thënë se kishte dëgjuar se V.K. ishte dhunuar nga të tjerët, dhe jo nga vetë viktima.

Ai ka thënë se dëshmitari Rr [REDACTED] i kishte thënë M [REDACTED] se viktima i kishte thënë atij se ata dy njerëz në fakt e kishin dhunuar atë. Sido që të jetë, kjo deklaratë nuk është konfirmuar nga Rr [REDACTED] i cili ka thënë se ai nuk kishte folur me viktimën fare.

Z. Brklač ka thënë se Gjykata e Apelit nuk ka thënë asnjë fjalë lidhur me raportin e zyrtarit të Policisë, Michael Nelson, të datës 16 shtator 2010, në bazë të cilit ai kishte marrë informata nga Znj. Merselot se viktima e kishte informuar atë se ajo ishte dhunuar nga një person.


Ai pohoi një alibi duke thënë se i pandehuri Bojkoviç ishte në Prishtinë përgjatë bombardimit në vitin 1999 me familjen e tij sikurse që është konfirmuar nga dëshmitari S.M. Ky dëshmitar ka thënë se gjatë bombardimit ai madje as edhe një herë nuk e kishte parë Bojkoviçin në Babin Most.

Ai më tej theksoi se Gjykata e Apelit ka gabuar në cilësimin e veprës penale kur erdhi në përfundim se dhunimi i dytë ishte kryer nën kontekstin e drejtpërdrejt të konfliktit që zhvillohej, duke krijuar kështu lidhjen në mes të konfliktit dhe të të pandehurit Bojkoviç si civil.

Të dy avokatët mbrojtës, Z. Pantoviç dhe Z. Brklač pretendojnë shkeljen e ligjit sa i përket vendimit mbi dënimin pasi që ekzistonte vërtetimi i gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Avokatët mbrojtës i propozuan Gjykatës Supreme të Kosovës që të anulojë Aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës së Apelit, që të refuzojnë Ankesën e PSRK-së si të pabazuar dhe ta konfirmojë Aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Parë apo ta kthejë rastin në Gjykatën e njëjtë, në Gjykatën e Shkallës së Parë, për rigjykim.

III. Përgjigjja e Prokurorisë në ankesat

Në përgjigjen në ankesat, Prokurori ka thënë se Gjykata e Apelit drejtë ka themeluar faktet, duke iu referuar një Aktgjykimi paraprak të Gjykatës Supreme në të cilën Gjykata vendosi që mospërputhshmëritë e vogla në deklaratën e një dëshmitari të veçantë me faktet nuk e zhvlerësojnë



vlerën e tyre. Prokuroria gjithashtu thekson se mospërputhshmëritë e vogla në mes të deklaratave të viktimës rezultojnë nga procesi psikologjik të natyrës njerëzore, në veçanti kur viktimat kalojnë nëpër ngjarje traumatike.


Sa i përket procesit të identifikimit, Prokuroria ka theksuar se në të vërtetë viktimat ka thënë se autori i krimit ishte një njeri i vjetër i cili çalonte. Ka theksuar se viktimat ka pasur mundësi që të vëzhgonte të pandehurin një kohë pas datës së dhunimit dhe kjo e bënë të besueshëm identifikimin e fotografisë. Më tej është thënë se Gjykata e Apelit me të drejtë ka hedhur poshtë argumentin se viktimat në mesin e fotografive e kishte përzgjedhur të vetmen fotografi të një njeriu të vjetër. Prokuroria pajtohet me Gjykatën e Apelit se fakti që identifikimi i autorëve të krimit është bërë bazuar në intervistat paraprake dhe jo si pjesë e procesit të identifikimit nuk e bënë atë të papranueshme. Gjithashtu është theksuar se mungesa e informatave se si në të vërtetë ishte bërë identifikimi, Gjykata e Apelit me të drejtë ka ardhur në përfundim se viktimat dhe disa dëshmitarë kanë njohur autorin e krimit në raste të mëvonshme dhe madje ai ishte i njohur 12 vite pas identifikimit të parë bazuar në fotografi të ndryshme. Prokurori paraqet se identitetet e autorëve të krimit ishin vërtetuar përtej çdo dyshimit të bazuar sikundër edhe kryerja e krimit. Prokuroria paraqet se dënimi është në përputhje me dispozitat ligjore, të lexuara në vijë me njëra tjetrën. Prokurori kërkon nga Gjykata që t'i refuzojë ankesat.

IV. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Në shqyrtimin e ankesave, Gjykata Supreme e Kosovës vendos sikurse më poshtë:

- Ankesat janë të pranueshme. Ato janë parashtruar nga personi i autorizuar si dhe brenda afatit ligjor.
- Gjykata Supreme e Kosovës gjen se Aktgjykimi i ankimuar i dhënë nga Gjykata e Apelit nuk kërkon një intervenim, *ex officio*. Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës do të kufizohet në ekzaminimin e vetëm të atyre shkeljeve të ligjit për të cilat palët pretendojnë në ankesat e tyre në pajtim me dispozitat e KPK-së.
- Gjykata Supreme e Kosovës gjen se ankesat janë të bazuara.

Lidhur me arsyet e veçanta mbi të cilat mbështetet mbrojtja:




Gjykata Supreme gjen të pa bazuara pretendimet e avokatëve mbrojtës se Gjykatës së Apelit ka gabuar në kualifikimin ligjor të krimit sepse ishte e heshtur lidhur me Konventat e Gjenevës dhe protokollet e saja duke mos e specifikuar paragrafin e nenit 142, që mbrojtja pretendon të ketë tri paragrafë. Gjykata Supreme do të mjaftojë të thotë se neni 142 i KPRSFJ-së (tani neni 153, i KPPK) sanksionon veprimet si krime në vetvete pa ndonjë nevojë që të iu referohet Konventave të Gjenevës apo protokolleve të saja si baza ligjore që është i përbërë vetëm nga një paragraf që përmban disa fjali.

Sa i përket besueshmërisë së deklaratave të palës së dëmtuar, V.K. dhe nga dëshmitarët, Gjykata Supreme e Kosovës nuk pajtohet me avokatët mbrojtës se prania e çfarëdo mospërputhshmërie e deklaratave të dëshmitarëve vë në pikëpyetje besueshmërinë e tyre. Në parim, Gjykata nuk duhet të trajtojë çdo mospërputhshmëri të vogël të ndonjë deklarate të një dëshmitari të veçantë si zhvleftësim të vlerës provuese të tyre si tërësi ku ai dëshmitar megjithatë ka treguar mjaftueshëm thelbin e incidentit në detaje të kënaqshme.

Në rastin në fjalë, Gjykata Supreme gjen të besueshme deklaratat nga pala e dëmtuar, V.K. dhe të dëshmitarëve që kanë dëshmuar në këtë rast për deri sa ato deklarata nuk kanë të bëjnë me identifikimin e të dyshuarve. Pala e dëmtuar dhe dëshmitarët janë, në masë të madhe, të qëndrueshëm në përshkrimin e mënyrës si ishte kryer rrëmbimi. Gjykata Supreme e Kosovës është e kënaqur me këtë përshkrim në lidhje me këtë dhe e konsideron si të mjaftueshme. Gjykata Supreme e Kosovës gjithashtu nuk pajtohet me avokatët mbrojtës që në rrethanat e mungesës së raportit mjekësor, është kontestuese nëse dhunimi në të vërtetë ka ndodhur fare. Gjykata konsideron se vetëm mungesa e raportit mjekësor nuk tregon që dhunimi nuk kishte ndodhur. Raportet mjekësore duhet të priten në rrethana normale. Sido që të jetë, në rastin në fjalë, mungesa e raporteve mjekësore është e arsyeshme për shkak të rrethanave të konfliktit të armatosur që mbizotëronte në atë kohë.

Gjykata Supreme e Kosovës është e kënaqur dhe e gjen si të vërtetuar se personi, në cilësinë e tij të zyrtarit të policisë serbe, gjatë periudhës kohore të konfliktit të armatosur në Kosovë, më 14 prill 1999, ka rrëmbyer V.K. shqiptare, civile, femër nga Kosova, duke e dërguar atë në një lokacion të panjohur, afër Babin Most. Ai pastaj e dhunoi atë duke e detyruar, deri sa i armatosur me pushkë dhe duke e kërcënuar atë me thikë, që të ketë forma të ndryshme të marrëdhënieve seksuale kundër vullnetit të saj, brenda veturës së tij. Përkundër mospërputhjeve në deklaratat e palës së dëmtuar, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron gjithashtu të vërtetuar se personi i dytë i etnitetit serb, më 14




prill 1999 ka dhunuar V.K. duke e dërguar atë në një shtëpi të papërfunduar në Babin Most, duke e hedhur atë në dysheme dhe duke e detyruar që të bëjë marrëdhënie seksuale pa vullnetin e saj.

Pavarësisht nga fakti se ka mospërputhje në deklaratat e palës së dëmtuar lidhur me numrin e dhunuesve dhe formën e marrëdhënieve seksuale, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se ato mospërputhshmëri nuk i dëmtojnë gjetjet e përgjithshme të Gjykatës paraprahe që krimet e tilla ishin kryer. Duke mos i konsideruar mospërputhshmëritë lidhur me numrin e dhunuesve si të vogla, Gjykata Supreme e Kosovës nuk do të nënçmojë faktin se mund të ketë brenga të arsyeshme të viktimës që ajo të kufizojë veten e saj në një shoqëri të tillë të mbyllur të atyre kohërave pa hyrë në detaje të shkencës sociale në atë kuptim, por më tepër duke u kufizuar në çështje legale që të duhet trajtuar. Në fund, Gjykata Supreme gjen deklaratat e viktimës si të qëndrueshme dhe përfundon se ajo ishte dhunuar nga dy dhunues.

Megjithatë, Gjykata Supreme konsideron se nuk është provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, ashtu siç kërkohet me ligj, se të pandehurit në këtë rast ishin personat të cilët kanë kryer ato veprime për shkak të mangësive në identifikimin e autorëve të krimit që nuk buron nga viktima apo dëshmitarët por nga procesi se si ishte zhvilluar identifikimi.

Fillimisht, për sa i përket pranueshmërisë së deklaratave të dhëna nga pala e dëmtuar dhe nga dëshmitarët, Gjykata Supreme e Kosovës thekson se neni 153, i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) që ishte aplikuar gjatë procedurës paraprahe në këtë rast penal parasheh që *"provat e marra në kundërshtim me dispozitat e procedurës penale do të jenë të papranueshme kur ky Kodi apo dispozitat e tjera të ligjit shprehimisht parashikojnë kështu"*. Neni 161, i KPPK-së përcakton se deklarata e personit që është ekzaminuar si dëshmitar do të jetë e papranueshme nëse *"dëshmia është siguruar me anën e forcës, kërcënim apo me anën e mjeteve të tilla të ngjashme, sipas nenit 155, të KPPK-së"* (pengesa absolute). Për më shumë, neni 155, i KPPK-së parasheh se në *"në çdo marrje në pyetje apo ekzaminim është e ndaluar të dëmtohet liria e personit, të formohet mendimi i tij apo i saj dhe që të shprehet çka ai apo ajo mendon me anën e keqtrajtimin, shkakimit të lodhjes, ndërhyrjes fizike, administrimit të drogës, torturës, detyrimit apo hipnozës, kërcënimit me masa që nuk lejohen me ligj, duke e përdorur avantazhin që nuk parashikohen me ligj, dhe duke e dëmtuar kujtesën e tij apo të saj ose aftësinë e tij apo të saj për të kuptuar"*.



Kështu, kur autoriteti i cili e drejton procedurën e merr deklaratën nga pala e dëmtuar apo nga dëshmitarët me anën e formave jo të lejuara me ligj sikurse është përcaktuar me nenin 155, të KPPK-së, ajo është provë e papranueshme. Megjithatë, ligji nuk e bënë në mënyrë automatike dëshminë të papranueshme thjesht për gabimet procedurale që i bëjnë autoritetet të cilat drejtojnë procedurat. Parregullsitë eventuale, që nuk përbëjnë shkelje esenciale të procedurës penale në bazë të nenit 155, të KPPK-së nuk kërkojnë që një deklaratë të konsiderohet si papranueshme me kusht që prova është paraqitur në pajtim me dispozitat që rregullojnë provat dhe palëve u jepet mundësia që t'i sfidojnë ato. Këto parregullsi, megjithatë mund të jenë të rëndësishme për qëllime të vlerësimit të besueshmërisë dhe kur vlera e tyre dëshmuese është vënë në pikëpyetje.

Në rastin në fjalë, Gjykata Supreme e Kosovës nuk gjen ndonjë dëshmi që tregon se deklaratat nga palët e dëmtuara apo dëshmitarët janë siguruar në mënyrë që nuk lejohen me ligj. Është gjithashtu evidente se deklaratat nga palët e dëmtuara dhe nga dëshmitarët janë paraqitur në pajtim me ligjin dhe palëve në procedurë u janë dhënë mundësi të bollshme që t'i sfidojnë ato. Ligji qartë e specifikon se kur një dëshmi është e papranueshme dhe mosrespektimi i formaliteteve në identifikimin e autorit të veprës penale, siç është rasti këtu, nuk hyn në këtë kategori. Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës nuk pajtohet me avokatët mbrojtës se deklaratat e palës së dëmtuar V.K. dhe të dëshmitarëve në këtë rast janë të papranueshme. Pavarësisht përfundimit të Gjykatës Supreme në lidhje me atë çështje, pyetja tash që të adresohet është nëse mospërputhjet e tilla me formalitetet dhe parregullsitë në identifikimin e autorëve të krimit nga viktimat janë të mjaftueshme që të arrihet në përfundim se të pandehurit janë autorët e krimit në fjalë.

Gjykata Supreme vë në dukje se dokumenti i parë sa i përket identifikimit është deklarata e viktimës e dhënë më 13 tetor 1999, për zyrtarin e UNMIK-ut. Duke e përshkruar se si kishte ndodhur rrëmbimi nga shtëpia dhe dhunimi nga i pandehuri i parë, pa e përmendur dhunuesin e dytë fare, duke e dhënë përshkrimin e zyrtarit të policisë si "i gjatë, me flokë të zezë të shkurtra, ngjyra e syve ishte e gjelbër në të kaftë, i dobët, dora e djathtë ishte e mbështjellë me fasha" pas përfundimit të deklaratës së saj dhe nënshkrimit, është theksuar në atë dokument se "asaj i kujtohet se më 10.10.1999 ajo kishte shkuar te PU e UÇK-së". Ata i treguan asaj ca fotografi dhe ajo kishte identifikuar policin i cili e kishte dhunuar atë dhe ata i thanë asaj se personi ishte nga fshati Babin Most". Kjo do të thotë se asaj i janë treguar disa fotografi të disa policëve dhe në mesin e tyre ajo kishte identifikuar njërin, por Gjykatës Supreme i mungojnë dëshmitë se si kishte rrjedhur procesi i identifikimit apo se si

fotografitë i janë treguar asaj dhe se ku janë ato fotografi. Përveç mungesës së dokumentit në procesin e identifikimit si të tillë, Gjykata nuk mund të di nëse një deklaratë e tillë e anëtarëve të UÇK-së kanë megjulluar kujtesën e saj sa i përket personit i cili kishte kryer krimin. Identifikimi tjetër ndodhi më 17 korrik 2012 e cila nuk përputhet me dispozitën e nenit 155 të KPPK-së as me rendin për të ndjekur si dhe njoftimet që i bëhen viktimës. Së fundmi, ajo kishte bërë identifikimin e tyre në shqyrtim kryesor që ajo mori pjesë përmes video lidhjes, ku megjithatë, në atë rast vetëm të pandehurit ishin ngritur, në përputhje me rrethanat, i mungonte pika që autorët e krimit ishin njohur në mesin e shumë personave pa asnjë dyshim. Kështu, Gjykata Supreme konsideron se identifikimi i autorëve të krimit nga viktima ka nevojë për mbështetjen në prova mbështetëse vërtetuese në këtë drejtim. Në këtë pikë, Gjykata ekzaminon deklaratat e dëshmitarëve dhe identifikimet e bëra nga ata.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen përshkrimin e autorit të parë të krimit nga pala e dëmtuar dhe nga dëshmitarët të përgjithshëm dhe jo të mjaftueshëm që të arrij përfundimin se ai ishte personi që e kishte kryer dhunimin. Sa i përket dhunuesit të dytë, ekziston vetëm përshkrimi i dhënë nga pala e dëmtuar e cila nuk është vërtetuar mjaftueshëm nga dëshmitë tjera mbështetëse. Për të ilustruar këtë, në deklaratën e datës 21 mars 2012, dëshmitari N.K. ka përshkruar kryerësin e parë të veprës penale si *"personi ishte i gjatë rreth 185 cm, përfaqësisht 30 - 35 vjeçar, peshë normale e trupit, ngjyra e flokëve kafe pak gri, kishte kapelë ushtarake mbi kokë, dora e tij e majtë ishte e mbështjellë me fasha, nuk më kujtohet diçka tjetër. Duke e konsideruar se kohë e gjatë ka kaluar, unë nuk jam shumë i sigurt por besoj se nëse e shoh atë përsëri, mund ta identifikoj"*. Sa i përket dhunuesit të dytë, ai deklaroi se, sikurse që V.K. e përshkroi autorin e dytë të krimit si, *"pak i shkurtër, i vjetër dhe duke çaluar"*. I njëjti dëshmitar, N.K. e ka përshkruar në deklaratën e tij më 04 mars 2003 autorin e parë të krimit sikurse më poshtë, *"me uniformë, ushtarake serbe, me armë AK 47, gjithashtu me revole në brezin e tij, të quajtur, revole TT, përfaqësisht 180 cm i gjatë, dukej i madh sepse të gjithë ishim të frikësuar. Ditën tjetër ai e rrëmbeu motrën time"*. Dëshmitarja, H.K. në deklaratën e saj të datës 21 maj 2012, e ka përshkruar autorin e veprës si *"shumë i dobët, fytyra dhe mjekra e tij ishin të mprehtë"*. Pala e dëmtuar, V.K. në deklaratën dhënë në UNMIK, ka thënë se *"më 14 prill 1999, në shtëpinë time erdhi zyrtari i policisë serbe. Atë ditë e pasq atë njeri për herë të parë. Gjatë dhunimit ai mbante pushkën e tij automatike në fytyrë tim. Viktima e përshkruan dhunuesin e parë si të gjatë, me flokë të shkurtër të zinj, ngjyra e syve ishte e gjelbër-kafe, ishte i dobët, dhe dora e djathtë ishte e mbështjellë me fasha"*. Ajo e përshkroi dhunuesin e dytë si, *"civil, kishte të veshura xhins të kaltra dhe xhaketë ngjyrë kafe, ishte i gjatësisë mesatare, me peshë mesatare, nuk më kujtohet ngjyra e syve të tij, me flokë të zj, ishte pak tullac dhe kishte mjekër"*. Deri sa ata e



kthenin atë në shtëpi, ajo deklaroi se “dy personat flisnin gjubën serbe me njëri tjetrin, ndërsa me mua zyrtari i policisë fliste në gjubën shqipe”. Njëjtë, pala e dëmtuar në deklaratën e saj më 24 gusht 2010 e përshkruan autorin e krimit si, “një njeri me uniformë të policisë, me ngjyrë të kaltër të mbyllur dhe me një lloj shenje në mëngët e tij të këmbës që tregonin se ai ishte polic serb. Zyrtari kishte mitraloz dhe thikë që ishte e dukshme dhe mendoj se ishte AK 47, ai ishte i gjatë rreth 1.75 – 1.80 cm, me flokë të shkurtër të mbyllura, me lëkurë ngjyrë mesatare, ishte i lënduar dhe dorën e majtë e kishte të mbështjellë me fashe, i ndërtuar mesatarisht, i dobët, moshë 29 – 35 vjeçar, ai fliste serbisht”. Pala e dëmtuar e jep përshkrimin e dhunuesit të dytë si, “një njeri i vjetër, ndoshta rreth 60 - 70 vjeçar. Njeriu fliste gjubën shqipe por ajo mendon se ai ishte serb, duke çaluar pak, ai ishte jo shumë i gjatë, në mes 1.67 – 1.71 cm, duke folur gjubën shqipe, por jo si gjubë të tij amtare”. Për më shumë, pala e dëmtuar V.K. në deklaratën e saj të datës 17 korrik 2012 e përshkruan dhunuesin e parë si “175 - 180 cm të gjatë, ai ishte i dobët, dhe kishte tipare të errët dhe flokë të zinj të shkurtër, ai kishte të veshur uniformë kamuflazhe të policisë me simbol në krabun e tij të shkruar “Milicija”. Ai kishte dorën e majtë të tij të mbështjellë me fashe, ishte i moshës rreth 27 – 33 vjeç, kishte një pushkë automatike me kondak të drurit, në brezin e tij kishte një thikë të gjatë të pushkës automatike, dhe ai fliste pak gjubën shqipe”. Pala e dëmtuar, V.K. e përshkruan dhunuesin e dytë si, “ai ishte rreth 50 - 60 vjeçar, ai kishte një trup i shëndoshë, flokët e tij kishin gjatësi mesatare me ngjyrë gri, ishte rreth 165 - 170 cm i gjatë dhe çalonte me njërin këmbë, dhe ai fliste gjubën shqipe dhe kishte armë në brezin e tij”. Dëshmitarja, H.K. më 31 mars 2003 e përshkruan si, “njeri me uniformë kamuflazh dhe me armë automatike”. Në pyetjen nëse ajo mund të e përshkruajë ushtarakun që e kishte rrëmbyer vajzën e saj, ajo deklaroi se “nuk mund ta mbaj mend saktësisht sepse ka kaluar një kohë e gjatë”. Në pyetjen nëse ajo mund të e dallonte atë nëse i tregohet fotografia e këtij personi, ajo u përgjigj, “ndoshta, por nuk mund të e jap përshkrimin e tij”. Dëshmitarja tjetër, M.K. (e cila ishte rreth 11 vjeçare në kohën e incidentit) në deklaratën e saj të datës 26 prill 2012, si përgjigje në pyetjen nëse ajo mund të e përshkruaj zyrtarin e policisë, deklaroi, “Unë isha shumë e re në atë kohë dhe mendoj se ishte njeri i gjatë, me ndërtim mesatar, me flokë të zinj të shkurtër. Nuk më kujtohet ngjyra e syve të tij edhe pse isha 4-5 metra larg tij. Nuk më kujtohet ndonjë gjë tjetër për të, por mendoj se ai ishte rreth 30 vjeçar”. Ajo vazhdojë më tutje, “Mendoj se e kam parë atë në vitin 2010, në fshatin, Stanovë i Ulët, në dyqanin e R. M. Ai blinte ca gjëra. Më dukej i njohshëm, por nuk e dëgjova që të fliste gjubën serbe. Mendova se ai ishte që e kishte marr V. K. Unë isha e befasuar kur e pasq atë të ketë veshur uniformën e Policisë së Kosovës”. Në deklaratën e dëshmitares I. G. (e cila ishte rreth 16 vjeçare në kohën e incidentit), të datës 26 prill 2012, në pyetjen nëse ajo mund të e përshkruaj personin i cili e kishte marr V. K. me vete, ajo ka thënë se, “ai ishte rreth 30 vjeçar, me ndërtim mesatar, rreth 175 - 180 cm i gjatë, me flokë të shurtë, të zezë, me sy të zinj dhe me vetulla të zezë”.



Dëshmitarja X.K. në deklaratën e saj të datës 01 prill 2003, në pyetjen nëse mund ta përshkruajë atë, deklaroi se, *“ai ishte i gjatë, i dobët, i veshur në uniformë gri, ngjyra fytyrës ishte e errët, mbante armë automatike”*.
Më tej, dëshmitari M.K. në deklaratën e tij të datës 1 prill 2003 në pyetjen nëse mund ta përshkruajë atë, deklaroi se *“ai ishte më i gjatë se unë, më i gjatë se 180 cm. Ishte i dobët. Me fytyrë të errët, nuk më kujtohet ngjyra e flokëve të tij. Ishte me uniformë gri dhe ndoshta polic rezervist. Ai nuk ishte polic i rregullt, dhe gjithashtu mbante armë automatike. Ndoshta nuk do të mund ta identifikojë sepse ishte errësirë”*.


Bazuar në krahasimin e të gjitha deklaratave të palës së dëmtuar, e gjithashtu edhe të dëshmitarëve, Gjykata Supreme e Kosovës e konsideron se përshkrimet e autorëve të krimit janë të përgjithshme dhe të paqarta të cilat nuk mjaftojë që të arrihet përfundimi përtej dyshimit të bazuar se të pandehurit në këtë rast ishin ata të cilët kishin kryer veprat penale.

Gjykata Supreme e Kosovës gjithashtu gjen mangësi thelbësore në procesin e identifikimit të të pandehurve. Pasi që identifikimi është faktor vendimtar, që është vendimtare në përcaktimin e fajësisë së personit, mangësitë nuk duhet që të nënvleftësohen dhe kur janë të pranishme ato gjithmonë duhet që të interpretohen në të mirë të të pandehurit. Identifikimi duhet që të shpjegohet në një shkallë të tillë që dëshmitë në fund nuk lënë asnjë dyshim sa i përket pranisë së këtyre elementeve. Përndryshe, Gjykata duhet që të veprojë në pajtim me parimet e ndërtimit në të mirë të të akuzuarit (*favor rei*), e konceptuar gjithashtu si një standard që rregullon vlerësimin e provave.

Në rastin në fjalë, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se identifikimi nuk është bërë në pajtim me dispozitat e KPPK-së. Sa i përket të pandehurit të parë, është evidente se nga tetë fotografitë e treguara tek pala e dëmtuar dhe tek dëshmitarët e rastit, vetëm një fotografi, e Jovica Dejanoviç ishte shënjuar, kështu duke e ngritur shqetësimin se pala e dëmtuar dhe dëshmitarët kanë pas mundësi të jenë udhëzuar në identifikimin e kryerësit të veprës penale.

Sa i përket të pandehurit të dytë, fotografitë e treguara tek pala e dëmtuar përmbanin pamje të personave të rinj dhe vetëm një fotografi tregonte Gjorgje Bojkoviç në pamjen e një personi të vjetër që përkonte me deklaratën e palës së dëmtuar, se dhunuesi i dytë ishte një person i vjetër.

Duke e marr parasysh se identifikim i autorëve të krimit nuk ishte bërë në mënyrë të duhur dhe duke e konsideruar mungesën e dëshmimeve shtesë të cilat i vërtetojnë deklaratat e palës së dëmtuar dhe të



dëshmitarëve, Gjykata Supreme e Kosovës është e mendimit se akuzat kundër të pandehurve nuk janë vërtetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, sikurse që kërkohet me Ligj.

Gjykata Supreme e Kosovës është e mendimit se pretendimet e tjera të ngritura nga avokatët mbrojtës janë pa ndonjë efekt në rezultatin e përgjithshëm të rastit dhe si e tillë çdo shtjellim i mëtejshëm do të ishte i tepërt.

IV. Përfundimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

Duke pasur parasysh ato që u thanë më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vendos sikurse në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

PA-IIKZ-II-5/2014, Data, 01 tetor 2014

Kryetare e Kolegjit:

Procesmbajtës:

Nesrin Lushta

Adnan Isufi

Gjyqtare në Gjykatën Supreme

Këshilltar Ligjor i EULEX-it


Anëtarët e Kolegjit:

Esma Erterzi

Willem Brouwer

Gjyqtare e EULEX-it

Gjyqtar i EULEX-it



Republika e Kosovës



Republika e Kosovës

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik